

Një Vështrim mbi
**Treguesit e Zhvillimit
Ekonomik të
Shqipërisë,
6M-I 2024**

Sekretariati i Këshillit të Investimeve
Korrik 2024





Ky publikim është një përmbledhje e treguesve kryesorë makroekonomikë në Shqipëri të publikuara nga burime zyrtare kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ky dokument nuk paraqet pikëpamjet e Sekretariatit ose Këshillit të Investimeve.

▶ PËRMBAJTJA

- ▶ Censusi 2023
 - ▶ Llogaritë Kombëtare
 - ▶ Tregtia e Jashtme
 - ▶ Tregu i Punës
 - ▶ Investimet
 - ▶ Treguesit Monetarë

Një Vështrim mbi
Treguesit e Zhvillimit
Ekonomik të Shqipërisë,
6M-I 2024

Censusi i popullsisë dhe banesave 2023

Censi i Popullsisë dhe Banesave 2023 është censi i tretë i kryer në Shqipëri, prej nga viti 1990, dhe i dymbëdhjeti në historinë e censeve në vend, prej vitit 1913.

POPULLSIA

- Popullsia banuese në Republikën e Shqipërisë më 18 shtator 2023 rezultoi **2.402.113**, me rënie prej **420 mijë persona**, krahasuar me Censin e 2011.
- Dendësia e popullsisë së Shqipërisë është **83,6 banorë** për km².
- Raporti gjinor i popullsisë rezulton **98,2 meshkuj** për 100 femra.
- Pesë në gjashtë persona të moshës njëqind vjeçare në Shqipëri janë gra. Përafërsisht, një e treta e popullsisë shqiptare (**31,6 përqind**) banon në qarkun e Tiranës.

ARSIMIMI

- Shkalla e alfabetizmit për popullsinë e moshës 15 vjeç e lart është **97,7 përqind**.
- Të dhënat e Censit tregojnë se **96,8 përqind** e popullsisë së moshës 15 vjeç e lart kanë përfunduar ose janë duke ndjekur shkollën.
- Përqindja e femrave me arsim të lartë ka ardhur vazhdimisht në rritje, nga **41,1 përqind** në Censin e 2001 në **51,0** në Censin e 2011 dhe **55,7** përqind në Censin e 2023.

Censusi i popullsisë dhe banesave 2023

NJËSITË EKONOMIKE FAMILJARE DHE BANESAT

- Numri gjithsej i NjEF është **755.950**, *rritur me 4,7 përqind, krahasuar me Censin 2011.*
- Madhësia mesatare e NjEF është **3,2 anëtarë**, *krahasuar me 3,9 anëtarë për NjEF në Censin e 2011.*
- Rreth një në katër NjEF - **24,3 përqind** – kanë si person reference grua, personi i cili përgjithësisht merr vendimet kryesore në NjEF dhe njihet si i tillë nga të gjithë anëtarët e saj.
- Shumica e NjEF me **82,5 përqind** janë pronarë të banesës ku jetojnë.
- **11,4 përqind** e NjEF zotërojnë panele diellore, **8,7 pikë përqindje** më shumë, krahasuar me Censin 2011.
- Përqindja e banesave të zakonshme të pabanuara është 32,9 përqind.

Një njësi ekonomike familjare (NjEF) i referohet një grupi personash ose një personi me lidhje gjaku ose jo të cilët banojnë së bashku në një banesë dhe që ndajnë një ekonomi pjesërisht ose plotësisht të përbashkët.

Ecuria e Treguesve Kryesore Makroekonomikë

Rritja ekonomike T1 2024 - *Rritja e PBB-së*: 3,63% rritje krahasuar me T1 2023. *Sektorët kryesorë* me ndikim pozitiv: “Ndërtimi”, “Administrata Publike, Arsimi dhe Shëndetësia”, “Tregtia, Transporti, Akomodimi dhe Shërbimi Ushqimor”.


Tregtia e Jashtme - *Eksportet në 6MI të 2024*: 199 miliardë lekë (14,8% rënie krahasuar me një vit më parë). Importet: 440 miliardë lekë (0,3% rritje krahasuar me një vit më parë). *Deficiti tregtar në 6MI të 2024*: 241 miliardë lekë (17,5% rritje krahasuar me një vit më parë). Mbulimi i importit: 45,3%.

Inflacioni dhe kurset e këmbimit - *Inflacioni mesatar*: 2.4% në gjysmën e parë të 2024, më i ulët se 5.6% e një viti më parë. *Kurset e këmbimit*: Forcim i lekut kundrejt euros dhe dollarit.

Tregu i Punës - *Papunësia T4 2024*: Rënie me 0,2 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë. Punësimi: Rritje me rreth 7.901 punonjës krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë. Paga mesatare: 73.641 lekë në tremujorin e parë 2024, me një rënie prej 1,8% nga tremujori i mëparshëm.

Investimet e Huaja Direkte (IHD) - *Flukset hyrëse të IHD-ve T1 2024*: 15.3% rritje krahasuar me një vit më parë, 12% rënie krahasuar me tremujorin paraardhës. *Stoku i IHD-ve T1 2024*: 20,6% rritje krahasuar me një vit më parë, duke arritur në 13.740 milionë euro. *Sektorët kryesorë për IHD*: Pasuri të paluajtshme, veprimtari financiare dhe sigurime, industri nxjerrëse.

Rritja Ekonomike sipas Tremujorëve




Produkti i Brendshëm Bruto (P.B.B) në tremujorin e parë të vitit 2024 vlerësohet me rritje prej 3,63%, kundrejt tremujorit të parë të vitit 2023.

Burimi: INSTAT, Korrik 2024

Rritja Ekonomike sipas Tremujorëve

Rritja vjetore tremujore sipas aktiviteteve të ekonomisë




Gjatë tremujorit I 2024, aktivitetet që shënuan rënie në terma vjetorë janë Bujqësia, Pyjet dhe Peshkimi, dhe Industri, Energji dhe Uji. Ndërsa aktivitetet që shënuan rritje janë “Ndërtimi”, “Administrata Publike, Arsimi dhe Shëndetësia”, “Aktiviteti i Pasurive të Paluajtshme”, grupi i “Aktiviteteve profesionale dhe Shërbime administrative”, “Tregti, Transport, Akomodim dhe Shërbim Ushqimor”, “Aktiviteti Financiar dhe i Sigurimit”, grupi i aktiviteteve “Informacioni dhe Komunikacioni” dhe grupi i aktiviteteve “Arte, argëtim dhe çlodhje, aktivitete të tjera shërbimi”. Taksat Neto mbi produktet u rritën me 2,80%.

Burimi: INSTAT, Korrik 2024

Kontributi në Rritja Ekonomike (tremujore)

2024-TI Kontributi në rritje p.p sipas aktiviteteve të ekonomisë




Kontribut pozitiv kanë dhënë degët: “Ndërtimi”, “Administrata publike, Arsimi dhe Shëndetësia”, “Tregti, Transport, Akomodim dhe Shërbim ushqimor”, “Aktivitete të pasurive të paluajtshme”, “Aktivitete profesionale dhe Shërbime administrative” “Informacioni dhe Komunikacioni” me +0,06 pikë përqindje, “Aktivitete Financiare dhe të Sigurimit”, “Arte, argëtim dhe çlodhje; aktivitete të tjera shërbimi”.

Negativisht kontribuoi grupi: “Bujqësi, Pyje dhe Peshkim”, “Industri, Energji dhe Uji” “Taksat Neto mbi produktet” kontribuan pozitivisht me +0,36 pikë përqindje.

Burimi: INSTAT, Korrik 2024

Qarkullimi i Mallrave në Tregtinë e Jashtme

Tregtia e jashtme, miliardë lekë



Gjatë 6M të parë të vitit 2024 eksportet e mallrave arritën vlerën 199 mld lekë, duke u ulur me 14,9%, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 440 mld lekë, në të njëjtat nivele të një viti më parë.


Deficiti tregtar arriti vlerën 241 mld lekë, duke u rritur me 17,9%, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2023.

Përqindja e mbulimit të eksporteve ndaj importeve zbriti në 45,3%.

Burimi: INSTAT, Korrik 2024

Qarkullimi i Mallrave në Tregtinë e Jashtme

Importet sipas grupmallrave (në million lekë)




Importet në 6M të parë të 2024 janë rritur me +0,3 %, krahasuar me 6M e parë të 2023. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht janë: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +2,8 p.p, “Ushqime, pije, duhan” me +1,3 p.p. Ndërsa negativisht kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me -1,7 p.p, “Tekstile dhe këpucë” me -1,3 p.p, “Produkte kimike dhe plastike” me -0,4 p.p.

Gjatë këtij 6M të parë, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me 6M e parë të 2023 janë: Turqia (16,7 %), Greqia (16,8 %), Gjermania (3,6 %), etj. Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Italia (4,4 %), Kina (9,3 %), Maqedonia e Veriut (11,8 %), etj.

Burimi: INSTAT, Korrik 2024

Qarkullimi i Mallrave në Tregtinë e Jashtme

Eksportet sipas grupmallrave (në milionë lekë)



Eksportet, gjatë këtij gjashtëmujori janë ulur me 14,9 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar në uljen vjetore të eksporteve, janë: “Tekstile dhe këpucë” me -5,4 p.p, “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me -5,2 p.p, “Materiale ndërtimi dhe metale” me -2,2 p.p.


Gjatë këtij gjashtëmujori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur uljen më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, është: Italia (14,9 %), Kosova (1,5 %), Greqia (24,8 %), etj. Ndërsa vendi me të cilat eksportet kanë pasur rritjen më të madhe, është: Kina (25,0%), etj.

Burimi: INSTAT, Korrik 2024

Importet e Mallrave

Struktura e importeve të mallrave gjatë 6M-I 2024 dominohet nga importet e Makineri, Pajisje, Ushqimeve, Pije, Duhan dhe Materiale Ndërtimi dhe Metale.

Struktura e Eksporteve (në %)




Burimi: INSTAT, Korrik 2024

Eksportet e Mallrave

Eksportet sipas produkteve vazhdojnë të ruajnë strukturën e tyre ku pjesa më e madhe janë Tekstile dhe Këpucë të ndjekur nga Minerale lëndë djegëse, energji elektrike dhe Materiale ndërtimi dhe metale.


Burimi: INSTAT, Korrik 2024

Struktura e Eksporteve (në %)



Indeksi i Çmimit të Konsumit

Indeksi i Çmimeve të Konsumit, ndryshimi vjetor %




Përgjatë 6M-I 2024, inflacioni mesatar me bazë vjetore regjistroi vlerën 2,4%, më poshtë se niveli i një viti më parë prej 5,6%.

Bazuar në të dhënat e grafikut, duke filluar nga fundi i vitit 2011, inflacioni mujor me bazë vjetore ka qenë vazhdimisht poshtë objektivit të Bankës së Shqipërisë prej 3%, por tendeca rritëse janë vënë re duke filluar nga muaji Nëntor 2021, ku Inflacioni i regjistruar tejkaloi objektivin e BSH me ritme të larta dhe kjo tendencë vazhdoi deri në muajin tetor 2022 ku Inflacioni filloi rënien.

Burimi: INSTAT, Korrik 2024

Kursi i këmbimit


Kursi mesatar i këmbimit Lek/Euro



— Kursi i këmbimit mesatar (lekë/EURO) 2023

— Kursi i këmbimit mesatar (lekë/EURO) 2024

Kursi mesatar i këmbimit Lek/Usd



— Kursi i këmbimit mesatar (lekë/USD) 2023


— Kursi i këmbimit mesatar (lekë/USD) 2023

Përgjatë 6M I të vitit 2024 kursi mesatar i këmbimit lekë/Euro ishte 101,9 krahasuar me 112,9 që ishte një vit më parë; ndërsa kursi mesatar i këmbimit lekë/USD ishte 94,1, krahasuar me 104,4 të një viti më parë. Leku vazhdon forcimin e tij ndaj dy monedhave kryesore në vend.


Burimi: BSH, Korrik 2024

Kredia për ekonominë

Totali i kredisë në ekonomi (mln Lekë)



Kredia e re sipas aktivitetit ekonomik mln Lekë




Kredia totale për ekonominë në maj 2024 arriti në 782,9 miliardë lekë ndërsa shumica e kredisë së re gjatë 5M-I të vitit 2024 shkoi në tregtinë me shumicë dhe pakicë, Ndërtimi dhe Industria përpunuese duke vazhduar të njëjtin trend të një viti më parë. Gjatë 5M-I 2024 totali i kredisë së re për korporatat jofinanciare private u rrit me 54,5% krahasuar me një vit më parë.

Burimi: BSH, Korrik 2024

Forca e Punës

Norma e papunësisë



Në T4 2023, bazuar në të dhënat e publikuara, shkalla e papunësisë u ul me 0,2 p.p krahasuar me një vit më parë.


Referuar të dhënave të INSTAT në tremujorin IV 2023, numri i të punësuarve u rrit me rreth 7.901 persona krahasuar me të njëjtin tremujor një vit më parë.

Shënim: Publikimi i Anketës së punës T-I 2024 është shtyrë nga INSTAT për arsye metodologjike.

Burimi: INSTAT, Korrik 2023

Paga Mesatare dhe Paga minimale

Paga mesatare me baze mujore



Paga mesatare gjatë T-I 2024 (referuar të dhënave zyrtare të publikuara) është raportuar në 73.641 lekë me rënie 1,8% nga tremujori paraardhës.


Paga mesatare mujore për një të punësuar në sektorin privat ishte 68.686 lekë me një rënie 1% krahasuar me një vit më parë; Ndërkohë paga mesatare mujore për një të punësuar në sektorin shtetëror ishte 84.979 lekë, me një rënie 3,3% krahasuar me T-IV 2023.

Shënim: Të dhënat janë mesatare të shifrave tremujoreve publikuar nga INSTAT.

Burimi: INSTAT, Korrik 2024

Paga mesatare mujore bruto sipas aktivitetit ekonomik

Paga mesatare mujore bruto sipas aktivitetit ekonomik



Pagat më të larta vijnë të regjistruhen në sektorin “Veprimtari financiare dhe sigurime”, ndonëse me rënie nga një tremujor më parë, pasuar nga “Informacion dhe Komunikim”.


Pagat më të ulëta janë raportuar në sektorin “Bujqësia, Pyjet dhe Peshkimi”.

Paga mesatare mujore - është paga bruto që merr një i punësuar për punën që ka kryer


Burimi: INSTAT, Korrik 2024

Investimet e Huaja Direkte

Fluksi hyrës IHD me bazë tremujore



Stoku IHD me bazë tremujore




Gjatë T-I 2024, fluksi hyrës i IHD u rrit me 15,3% krahasuar me një vit më parë, dhe janë ulur me 12% krahasuar me tremujorin paraardhës.

Ndërkohë, gjatë T-I 2024, stoku i IHD u rrit me 20,6% krahasuar me një vit më parë duke arritur 13.740 milionë Euro dhe 3,3% më shumë se tremujori IV 2023.


Burimi: Banka e Shqipërisë, Korrik 2024

Investimet e Huaja Direkte

Stoku IHD sipas vendit të origjinës në mln Euro



Fluksi ID sipas shteteve në mln Euro




Vendet e tjera (konfidenciale) mbajnë vendin e parë me hyrjen më të lartë të IHD-ve për T-I 2024, 80 milionë euro e ndjekur nga Turqia me 69 milionë euro dhe Italia me 41 milionë euro.

Ndërkohë, Holanda kryeson me stokun e IHD-ve në vend për tremujorin e parë të vitit 2024, me 2.281 milionë euro ndjekur nga Zvicra me 2.115 milionë Euro.

Burimi: Banka e Shqipërisë, Korrik 2024

Investimet e Huaja Direkte

Fluksi IHD sipas aktiviteteve kryesore në mln Euro



Gjatë T-I 2024, sektori më tërheqës për IHD-të janë Aktivitetet e Pasurive të Paluajtshme, trend që vazhdon nga T-II 2023 (84 milionë euro) i ndjekur nga Aktivitetet financiare dhe të sigurimit (74 milionë euro) dhe Industria nxjerrëse (51 milionë euro).

Burimi: Banka e Shqipërisë, Korrik 2024

RRETH KËSHILLIT TË INVESTIMEVE NË SHQIPËRI

Këshilli i Investimeve ka si qëllim rritjen e besimit të ndërsjellë midis biznesit dhe qeverisë duke kontribuar në institucionalizimin e dialogut mbi politikat në vend. Kontribuon në reformat kombëtare dhe procesin e tranzicionit ekonomik duke ndihmuar në përmirësimin e institucioneve, ligjeve dhe politikave që promovojnë mirëfunksionimin e tregut.

Sekretariati i Këshillit të Investimeve - Stafi

Puna e Këshillit të Investimeve mbështetet nga Sekretariati, një organ i pavarur me profesionistë të përzgjedhur dhe kontraktuar nga BERZH për t'u angazhuar drejtpërsëdrejti me komunitetin e biznesit.

Dr. Diana Leka (Angoni)

Drejtoresh e Sekretariatit
lekad@investment.com.al

Elvis Zerva

Ekspert Ligjor dhe Rregullator
zervae@investment.com.al

Elida Fara

Eksperte Ekonomie
farae@investment.com.al

Xaira Shurdha

Eksperte për Monitorimin dhe Bashkëpunimin
shurdhax@investment.com.al

Elisa Lula


Oficere Administrative dhe Komunikimi
lulae@investment.com.al

Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI), Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri
info@investment.com.al / www.investment.com.al / SKI është përgjegjës për përmbatjen e këtij publikimi.

 Albania Investment Council

 ALInvestCouncil

 Albania Investment Council



Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO

Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, BERZH dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO).